



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2020:158682

Datë: 29.07.2022

Numri i dokumentit: 03279731

C.nr. 996/2020

GJYKATA THEMELORE GJILAN/DEGA NË VITI-Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Arben Xheladini, me bashkëpunëtorin profesional Adnan Hajdari, në çështjen kontestimore të paditëses, N.I. nga Vitia, e përfaqësuar me autorizim nga T.A., avokat nga Vitia, kundër të paditurës Komuna e Vitisë - DKA, e përfaqësuar nga Ekrem Shabani, Zytar Juridik, me objekt kontesti kompensimi i shpërblimit jubilar dhe shpenzimeve të ushqimit, vlera e kontestit 1, 996.50 Euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe publik, me datë 19.07.2022, jashtë seance, mori këtë:

AKT GJYKIM

I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditëses N.I. dhe, detyrohet e paditura Komuna e Vitisë-DKA, që paditëses, për shpërblim jubilar t'ia paguaj 50% të pagës bazë, shumën prej 210.50 Euro dhe për shpenzime të ushqimit ditor, për 768 ditë pune, për periudhën nga data 18.04.2017 deri më 17.04.2020 dhe nga data 22.01.2021 deri më 15.07.2022, t'ia paguaj shumën prej 1,536 Euro, të gjitha këto në shumë të përgjithshme prej 1,746.50 Euro, me kamatë ligjore prej 8% në vit nga data 13.11.2020 e deri në pagesën përfundimtare, në afat prej 7 ditësh, nga data e pranimit të aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit.

II. Refuzohet si e pa bazuar, pjesa e kërkesës së paditëses për pagimin e shpenzimeve të ushqimit në shumë prej 250 Euro, për 125 ditë periudhën nga data 18.04.2020 deri me 21.01.2021.

III. Detyrohet e paditura, që paditëses t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës, në shumë prej 270 Euro.

Arsyetim

Paditësja N.I., përmes përfaqësuesit të saj me autorizim, me padinë e datës 13.11.2020, të saktësuar me parashtresën e datës 18.07.2022, si dhe në seancën e shqyrtimit kryesor¹ ka kërkuar nga Gjykata, t'ia aprovojë kërkesëpadinë dhe të detyrohet e paditura DKA – Komuna e Vitisë që paditëses N.I., për shpërblim jubilar, për 10 vjet të përvojës së punës, t'ia paguaj 50% të pagës bazë, në shumë prej 210.50 Euro dhe për shpenzimet të ushqimit për 893 ditë pune, për periudhën nga data 18.04.2017 deri më 15.07.2022, në shumë prej 1,786 Euro, të gjitha këto në shumë të përgjithshme prej 1,996.50 Euro, me kamatë ligjore prej 8% në vit, nga data e parashtimit të padisë e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit.

¹ Gjykata ka caktuar seancë përgatitore dhe pas propozimit të përfaqësuesve të palëve, ka kaluar në shqyrtim kryesor të çështjes.

Bazën ligjore të kërkesëpadisë, paditësja e mbështeti në nenin 35, par. 7 dhe 8 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e datës 18.04.2017 si dhe Kontratës Kolektive, në fuqi nga data 22.01.2021, për shkak se, paditësja, është e punësuar si mësimdhënëse në SHFMU “Ndre Mjeda” në Kabash, paga bazë e të cilës është 421 Euro, dhe për periudhën e nga data 18.04.2017 deri më 15.07.2022, ka qenë e pranishme në punë 893 ditë. Përkundër kërkesës në procedurë jashtëgjyqësore, e paditura i është përgjigjur negativisht në kërkesat e saj. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar të specifikuara: për përpilim të padisë shumë prej 104 Euro, për një seancë të mbajtur gjyqësore, shumë prej 135 Euro dhe për taksë gjyqësore, shumë prej 31 Euro.

E paditura, në përgjigje në padi, e ka kontestuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses, duke e cilësuar si të pa bazuar në ligj, për faktin se DKA-Komuna e Vitisë nuk është përgjegjëse për moszbatimin e kontratës kolektive të vitit 2017, të cilën e ka nënshkruar Ministria e Arsimit dhe SBASHK, dhe nuk kanë ndarë mjete buxhetore për kompensimin e këtyre beneficioneve që dalin nga Kontrata Kolektive, andaj edhe ka kërkuar nga gjykata që kërkesëpadinë e paditëses ta refuzoj si të pa bazuar. E paditura nuk e ka kontestuar faktin e punësimit, ndërsa, e ka kundërshtuar kërkesën për shpenzime të ushqimit pas datës 18.04.2020, me arsyetimin se Kontrata Kolektive, pas kësaj date, deri më 21.01.2021 nuk ka qenë në fuqi, andaj edhe ka kërkuar që të zbriten 125 ditë pune.

Me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, Gjykata i ka administruar dhe vlerësuar këto prova: Kërkesën e datës 28.01.2020, Përgjigja në kërkesë e datës 11.02.2020, vërtetimin e datës 12.07.2022, me numër protokoli 1110/22 dhe listën e pagave.

Pas vlerësimit të secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, në bazë të nenit 8 të LPK-ës, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses N.I. është pjesërisht e bazuar.

Nga provat materiale të administruara dhe nga qëndrimi i palëve në procedurë, gjykata vërtetoi se, paditësja, është në marrëdhënie të punës si mësimdhënëse në SHFMU “Ndre Mjeda” në Kabash, ndërsa, për periudhën nga data 18.04.2017 deri me 18.04.2020, dhe për periudhën prej 22.01.2021 deri më 15.07.2022, paditësja ka qenë e pranishme në punë 768 ditë. Gjithashtu, u vërtetua fakti se, paditësja ka mbi 10 vjet të përvojës së punës.

Faktet për përvojën e punës, pagën bazë, ditët e pranisë së paditëses në punë, nuk u kontestuan nga e paditura, e po ashtu u vërtetuan një nga një me vërtetimin e datës 12.07.2022, me numër protokoli 1110/22 dhe listën e pagave.

Baza ligjore

Me nenin 90 paragraf 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 i datës 01.11.2010, përcaktohet se: “Marrëveshja Kolektive mund të lidhet: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve. Me paragrafin 1 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive mund të lidhet a) të nivel të vendit, b) në nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes. Me paragrafin 3 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektivë duhet të jetë në formë të shkruar, në Gjuhën Zyrtare të Republikës së Kosovës. Me paragrafin 4 përcaktohet se Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet”, ndërsa, në me paragrafin 5 përcaktohet se, “Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”.

Me nenin 35, par. 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit, të datës 18.04.2017 si dhe Kontratës Kolektive në fuqi është përcaktuar se: “Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë

punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restaurantit a kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin e ushqimit, ndërsa, për shpërblimin jubilar gjykata u bazua në nenin 35 par.8, pika 8.1 të këtyre kontratave, ku parashihet se: “Punëtorët (anëtarë të SBASHK-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit, në vlerë: [...] për 10 vjet të përvojës së punës, në vlerë të 50% të një page bazë [...]”.

Duke u bazuar në dispozitat e lartcekura ligjore, e po ashtu në bazë të nenit 245, paragrafi 1, të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve me Nr.04/L-077, ku përcaktohet se “*Kreditori në marrëdhëniet e detyrimeve ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij*”, gjykata e aprovoj pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses si të bazuar dhe e detyroj të paditurën si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ndërsa, sa i përket pjesës së refuzuar të kërkesëpadisë, në shumë prej 250 euro, e kërkuar në emër të kompensimit të shpenzimeve për ushqim, për periudhën nga data 18.04.2020 deri më 21.01.2021, Gjykata, e bazoj në faktin se nuk kishte bazë ligjore, pasi që Kontrata Kolektive e Arsimit, e dates 18.04.2017 ka skaduar me date 18.04.2020.

Me Ligjin të Punës 03/L-21, si ligj bazik, në nenin 90 paragrafi 4 shprehimisht është përcaktuar se: “*Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri(3) vjet*”. Andaj, Gjykata vlerëson se, Ligji i Punës, me këtë dispozitë e ka kufizuar në çdo rrethanë afatin për 3 vjet të kontratës kolektive. Ndërsa, referuar dispozitës të cituar më lart në nenin 90 të Ligjit të punës, e cila në paragrafin 6 shprehimisht përcakton se, “*Marrëveshja Kolektive nuk mund të përfshijë dispozita të tilla që kufizojnë të drejtat e të punësuarve që kanë si pasojë kushte më pak të favorshme të punës sesa ato të përcaktuara në këtë ligj*”, gjykata vlerëson se kjo dispozitë ka të bëjë me përmbajtjen e të drejtave dhe detyrimeve të marrëveshjes kolektive lidhur me të punësuarit dhe punëdhënësit, e jo me afatshmërinë kohore të kontratës kolektive, e cila është e kufizuar me Ligjin e Punës.

Pasi gjykata vërtetoi se paditësjja është e punësuar të e paditura, dhe gjatë periudhës si në dispozitiv të aktgjykimit ka qenë e pranishme në punë 768 ditë, kërkesat për shpenzime të ushqimit dhe të udhëtimit, u gjykuan si në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit.

Me qëllim të zbatimit të parimit të ekonomizimit të procedurës, gjykata nuk caktoi ekspert financiar pasi që shumica e përgjithshme për pagesë u bë sipas përlogaritjes së thjeshtë dhe nuk u kundërshtua nga përfaqësuesi i të paditurës.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet e të paditurës në përgjigjen në padi, të cilat u gjetën si të pa bazuara, për shkak se palët kontraktuese të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, (Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK), në nenin 2 kanë përcaktuar: “Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit (Komunat-DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj.) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës”. Për më tepër, në nenin 37 kanë përcaktuar se “palët nënshkruese të kësaj kontrate kolektive janë të obliguara që të zbatojnë dhe t'i respektojnë dispozitat e kësaj kontrate”. Për këto arsye, pavarësisht

se e paditura nuk i ka nënshkruar këto marrëveshje, përgjegjësia e saj për përmbushjen e detyrimeve buron nga neni 2 i kësaj Kontrate.

Lidhur me kamatën gjykata vendosi në bazë të nenit 382 të LMD-së, i cili përcakton se “Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. Lartësia e kamatëvonesës është tetë për qind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë”.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 452.1 të LPK-së, pasi që e paditura e ka humbur kontestin në këtë rast, andaj edhe e detyroi që paditëses t’ia paguajë shpenzimet e procedurës në shumë prej 270 Euro edhe atë: për përpilimin e padisë 104 Euro, për taksë gjyqësore 31 Euro si dhe për një seancë gjyqësore 135 Euro, duke u bazuar në Rregulloren për Tarifat e Avokatëve të Kosovës.

Nga të lartcekurat, e duke u bazuar në nenin 2 lidhur me nenin 142 pika 1 dhe 2 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-DEGA NË VITI
C.nr. 996/2020, datë 19.07.2022

Gjyqtari,

Arben Xheladini

Këshillë Juridike: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në Gjykatën Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afatin prej 7 ditëve, pas ditës së pranimit. Ankesa, në kopje të mjaftueshme, dorëzohet përmes kësaj gjykate.